

Ligjëratë nga lënda:

## **Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci Moderne**

Përmbledhje ligjërate VIII

### **Tregtia**

#### **Nga sigurimi te ekonomia politike**

- Veprimtaritë më të studjuara në Ekonominë Politike Ndërkombëtare (EPN) janë: tregtia, marrëdhëniet monetare dhe korporatat shumëkombëshe.
- Merkantilizmi e vë theksin tek përdorimi i politikës ekonomike për rritjen e fuqisë shtetërore në krahasim me shtetet tjera. Ai është i lidhur me realizmin:
- Liberalizmi e vë theksin mbi bashkëpunimin ndërkombëtar, sidomos nëpërmjet tregtisë së lire botërore, për rritjen e krikimin e përgjithshëm të pasurisë (pavarësisht prej shpërndarjes së saj ndërmjet shteteve). Nga pikëpamja konceptuale liberalizmi lidhet me idealizmin.
- Pjesa më e madhe e shkëmbimeve ndërkombëtare sjellin si rrjedhojë disa interesa konfliktuale dhe disa interesa të përbashkëta për shtetet që janë të përfshira në to. Marrëveshjet mund të bëhen sepse të dyja palët përfitojnë, kurse konflikti për përfundime të veçanta kërkon domosdoshmërisht përpjekje për t'u marrë vesh.
- Vëllimi i tregtisë botërore është shumë i madh, rreth 15% e veprimtarisë ekonomike botërore, dhe ai është i përqëndruar kryesisht në shtetet e perëndimit të industrializuar (Europa Perëndimore, Amerika e Veriut dhe Japoni-Paqësori).
- Tregtia krijon pasuri nëpërmjet lejimit të shteteve që të specializohen në prodhimin e mallrave e të shërbimeve për të cilat ata kanë një përparësi të krahasuar (dhe të importojnë mallrat e tjera për të cilat kanë nevojë).
- Shpërndarja e përfitimeve që vijnë prej një shkëmbimi përcaktohet nga çmimi i mallrave të shkëmbyera. Duke pasur shumë blerës e shitës, çmimet përgjithësisht përcaktohen nga baraspesha e tregut (oferta-kërkesa).
- Shtetet komuniste gjatë Luftës së Ftohtë kishin në veprim ekonomi të planifikuara nga shteti, në të cilat qeveritë kombëtare përcaktonin çmimet e jepnin burimet.
- Politika ndërhyr në tregjet ndërkombëtare në shumë mënyra, përfshirë përdorimin e sanksioneve ekonomike si mjet ndikimi politik mbi një shtet të caktuar. Megjithatë, sanksionet është e vështirë që të zbatohen, nëqoftëse jot ë gjithë aktorët kryesorë ekonomik janë të një mendjeje për t'iu përmbajtur atyre.
- Shtetet po bëhen gjithnjë e më shumë të ndërvarur, në kuptimin që mirëqenia e shteteve varet nga bashkëpunimi me njëri-tjetrin. Disa studjues kanë argumentuar prej kohësh se rritja e ndërvarësisë e bën forcën ushtarake një formë më pak të dobishme ndikimi në përpjekjet ndërkombëtare për marrëveshje.
- Shtetet që e kanë pakësuar varësinë e tyre prej të tjerëve, duke ndjekur autarkinë e mbështetur në forcat e veta, kanë dështuar në krijimin e pasurisë së re për rritjen e mirëqenies së tyre.

Mbështetja në forcat e veta, ashtu si planifikimi shtetëror, është bërë gjërësisht i pabesueshëm si një strategji ekonomike e suksesshme.

- Nëpërmjet politikave proteksioniste shumë shtete mundohen që të mbrojnë industri të caktuara vendase prej konkurrencës ndërkombëtare. Të tilla politika kanë prirje që të ngadalsojnë krijimin botëror të pasurisë, por ndihmojnë shumë industrinë për të cilën bëhet fjalë.
- Proteksionizmi mund të ndiqet nëpërmjet shumë mënyrave, përfshirë tarifatat e importit (metoda e përkrahur), kuotatat, ndihmat shtetërore dhe pengesat e tjera jotarifore.
- Industritë shpesh grupohen për t'u kërkuar qeverive të tyre mbrojtje. Në shumë shtete qeveritë përpunojnë politika industriale për të udhëhequr përpjekjet e tyre për forcimin e industrive vendase në rrethanat e tregjeve botërore.
- Prodhime të caktuara, sidomos ushqimi, prona intelektuale, shërbimet dhe mallrat ushtarake, kanë prirje që të shmangen më shumë se sat ë tjerët prej parimeve të tregut. Konfliktet politike ndërmjet shteteve, në lidhje me tregtinë e tyre, janë të shpeshta.
- Një treg botëror që mbështetet në tregëtinë e lire është një e mirë e përbashkët.
- Meqenëse nuk ka qeveri botërore për të zbatuar rregullat e tregtisë, një zbatim i tillë varet nga ndërsjelltësia e pushtetit shtetëror. Në veçanti, shtetet i përgjigjen në mënyrë të ndërsjelltë bashkëpunimit të njëri-tjetrit në tregjet e hapura.
- Me kalimin e kohës, rregullat e mishëruara në regjimet tregtare (dhe në fusha të tjera të MN) bëhen themeli i institucioneve të përhershme, veprimtaritë administrative të të cilëve krijojnë qëndrueshmëri të mëtejshme e frytshmëri në tregtinë botërore.
- World Trade Organization (WTO), e cila më parë ka qenë GATT, është marrëveshja tregtare shumëpalëshe botërore më e rëndësishme.
- Raundi i bisedimeve zyrtare të GATT-it në Uruguaj, i cili përfundoi në vitin 1994, i shtoi qindra miliardë dollar krijimit të pasurisë botërore.
- GATT-i u institucionalizua në vitin 1995 me krijimin e WTO-së e cila e rriti vëmendjen mbi mallrat industriale duke përfshirë edhe bujqësinë e shërbimet.
- Zonat e veçanta të tregtisë së lirë janë krijuar në Europë, Amerikën e Veriut (Kanada, Mexikë, SHBA).
- Kartelet ndërkombëtare përdoren sipas rastit nga prodhuesit kryesorë (nganjëherë së bashku me përdoruesit kryesorë) për të vendosur kontrollin e penguar në luhatjen e çmimeve të një malli në tregtinë botërore.
- Marrëveshjet e tregtisë së lirë kanë qar në një kundërpërgjigje prej grupeve të interesit që janë politikisht vepruese, të cilat janë ndikuar për keq nga globalizimi; këto përfshijnë sindikatat, OJQ-të e mjedisit e të drejtave të njeriut dhe disa përdorues.